



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

**Kryetarja e Komunës**

**01nr** \_\_\_\_\_

**Dt: 30.03.2015**

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11, 13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenit 96 të Ligjit për Procedurën Administrative nr.02/L-28, pas shqyrtimit të kërkesës së shefit të ZKKK-së z. Armend Behluli të dt: 26.03.2015, për ndryshimin e të dhënave të xhirollogarisë së kartelës bankare të z. Ergjan Shyti, të cilat janë të përshkruara në pikën e tretë të vendimit 01 nr.400-18301 i dt: 25.02.2015 , me të cilin është miratuar propozimi për mbulimin e shpenzimeve të pagesës së qirasë për 6 muaj, për strehimin e familjes z. Ergjan Shyti nga Gjakova, me dt: 30.03.2015 e miraton këtë:

**V E N D I M**

**I.** Korrigohet pika e tretë e vendimi të Kryetares së Komunës 01 nr.400 -18301 i dt: 25.02.2015 duke e përmirësuar numrin e xhirollogarisë së z. Ergjan Shyti dhe emërtimin e bankës, ashtu që kjo pikë riformulohet sipas korigjimit me të dhënat vijuese:

**Vlera e mjeteve financiare për pagesën e qirasë për 6 muaj do të bartet në mënyrë suksesive në xhirollogarinë e z. Ergjan Shyti nga Gjakova nr.1140147664000197 ProCredit Bank , i cili është i obliguar që këto mjete ti bartë në fondin e KPA-së , me destinim për pagesën e qirasë.**

**II.** Pjesa tjetër e vendimit 01.nr 400-18301 i dt:25.02.2015 mbetet tërësisht në fuqi, ndërsa vendimi për korigjimin e pikës së tretë të këtij vendimi prodhon efekte juridike në harmoni me këtë vendim, duke iu referuar nenit 96 të LPA –së, sipas të cilit lejohet korigjimi i akteve administrative në çdo kohë kur vërehen pasaktësitë e ndonjë akti .

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

**V.** Vendimi iu dërgohet :

- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Z. Ergjan Shyti nga Gjakova rr. “ UÇK” nr.14 hyrja I /4
- Arkivit

**Kryetarja e Komunës**

\_\_\_\_\_  
**Znj. Mimoza Kusari- Lila**